



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
KIMI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____

VENDI _____

KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 42202494549A

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrethë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrethët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR
TESTI
KIMI

1. Jelena ka vendosur që një ditë vere ta kalojë në një kafiteri në plazh. Ka porositur një pije freskuese, të cilën kamarieri ia solli. Kamarieri e dinte kiminë mirë dhe i tha asaj se pija që i ka sjellur asaj përmban një substancë të pastërt. Për cilën substancë bëhet fjalë?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- limunadë akull i fituar nga uji i çezmës
 sheqer pluhur kafe

2. Atomet e cilave elemente mundë të ndërtojnë lidhjen kovalente polare?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- dy metale të njëjtë dy jometale të njëjtë
 metali dhe jometali dy jometale të ndryshëm

3. Çka paraqitet me simbolin kimik?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- një atom i elementit kimik një molekulë e komponimit kimik
 përzierja homogjene dhe heterogjene ekuacioni i reaksionit kimik

4. Si quhet grimca neutrale më e imët e ndonjë elementi kimik?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- atom molekulë joni pozitiv joni negativ

5. Cila madhësi fizike mbetet me menzurë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- vëllimi masa temperatura presioni

6. Cilën veti e kanë metalet e cekura: hekuri, alumini, bakri, plumbi dhe zingu?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- e përcjellin rrymën elektrike. shkrihen në temperatura të ulëta.
- i tërheq magneti. kan nuansa të ndryshme të kuqe.
7. Cilës lloj të komponimit i përket komponimi me formulë kimike N_2O_3 ?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- oksideve hidroksideve acideve kryorave
8. Në çfarë mënyre mundë të vërtetojmë vetitë acido - bazike të një substance të panjohur?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- duke e nxehur deri sa të vlojë duke përzier me ujë
- duke peshuar masën me indikator (dëftonjës) përkatës
9. Cila është formula kimike e metanit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- CH_4 CH_3CH_2OH CH_3COOH CO_2
10. Cili prej reaksioneve kimike tregon adirimim?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- $2Na + Cl_2 \rightarrow 2NaCl$ $Zn + 2HCl \rightarrow ZnCl_2 + H_2$
- $2MgO \rightarrow 2Mg + O_2$ $C_2H_4 + Cl_2 \rightarrow C_2H_4Cl_2$
11. Si mundet të fitohet tretja e ngopur nga ajo e pangopur?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- duke shtuar tretës duke shtuar substancë të tretur
- duke derdhur një pjesë të tretjes duke kulluar tretjen e ngopur

12. Në tabelë janë dhënë temperaturat e vlimit të substancave të ndryshme.

Substanca	T_v (pika e vlimit)
A	-269 °C
B	100 °C
C	1750 °C
D	2595 °C

Cila prej substancave është në gjendje agregate të gaztë, në kushte normale, në 25 °C?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- A B C D

13. Jetnisi i ka zgjidhur detyrat ku ka shënuar që në përzierje gjinden 50 g sheqer dhe 200 g ujë. Ecuria e punës së Jetnisit është dukur si vijon:

$$\omega = \frac{50 \text{ g}}{250 \text{ g}}$$

$$\omega = 0,20$$

Çka paraqet 250 g në ecurin e tij ?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- masën e tretjes masën e tretësit
 masën e substancës së tretur pjesëmarrjen në masë të substancës së tretur

14. Cila është formula kimike e acidit nitrik?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- HNO₃ NH₃ NO₂ N₂O₃

15. Me cilën substancë duhet të reagojë HCl që produkti i reaksionit të jetë CaCl₂, H₂O dhe CO₂?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- CaCO₃ NaCl KOH MgO

16. Cila substancë, përpos oksidit (IV) të karbonit (CO₂), fitohet gjatë djegëjes së etanolit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- uji etani eteni etina

17. Janë dhënë substancat që hyjnë në reaksion kimik me magnezin. Cila prej tyre bën përjashtim?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.


- oksigjeni hidrogjeni helijumi klori

18. Atomi i elementit E ka numrin atomik 9. Sa është numri i elektromeve valente?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 1 7 8 9

19. Grafikoni tregon varshmërin e tretëshmëris të katër substancave të gazta nga temperatura.
Cila prej substancave të cekura ka tretëshmëri më të lartë në 10 °C?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- He
 CO
 CH₄
 O₂



20. Nëse aminoacidi përmban grupën funksionale të cekur, ngjyros rrethin në kolonën PO, a nëse nuk e përmban, ngjyros rrethin në kolonën JO.

	PO	JO
Karbonile	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Karboksile	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Grupa amine	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
KIMI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR